

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale për Ujësjiellës dhe KUZ

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
19511200-3, 31711400-7, 44163110-4.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 27,000,000 (*Njëzet e shtatë milion*) lekë pa tvsh

Shumatore e cmimeve për njësi: 5,643,431 (Pesë milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjielles Kanalizime Kamez Sh.aka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe

financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës, por në të njëjtën kohë duke mos e kufizuar pjesëmarrjen në një numër të vogël operatorësh.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme të lidhura me objektin që kërkohet të prokurohet:

- Sistemi manaxhimit të cilësive ISO 9001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Autorizimi duhet në formën origjinal ose kopje e njehësuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar. Autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të ketë të përcaktuar adresën e saktë të firmës që e ka lëshuar këtë dokument, adresën e postës elektronike, nënshkrimin dhe emrin e zyrtarit përgjegjës dhe vulën e shoqërisë. Në rast se Autorizimi nuk i përmban këto të dhëna dokumenti do të konsiderohet i pavlefshëm për qëllim kualifikimi

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- a) **2.4. Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë :** Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

1	Tuba HDPE SN8 (te 6-te dimensionet sipas tabelës)	6 copë
2	Tubat e ujesjellesit (nga zeri 1 deri te 21)	21 copë
3	Kapak gize per permasat 70x40, 60x40, 40x40	3 copë
4	Fashete PE elektrofuzive PN 16 Vetshpuese (zeri 273 deri ne 305)	33 copë

Mostrat duhet të dorëzohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit. Mos dorëzimi i mostrave brenda afatit do të sjellë skualifikimin e operatorit pjesëmarrës.

2.4.1 Kërkese në lidhje me mostrat:

Per zerin nr 1 ne tabelen se mesiperme - Tuba HDPE SN8 te te gjitha permasave operatori ekonomik duhet te vertetoj me ane te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE se keto tuba jane te prodhuar sipas Normes – EN13476 tipi B per tubat ne perdorim te ujesjellsave civil si dhe bashkimet e ketyre tubave sipas normes EN 681-1. Operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi.

Ne rastet qe Prodhuesi eshte subjekt qe ushtron aktivitetetin ne Republiken e Shqiperise duhet te vertetoj se disponon licence te posacme per te qene prodhues.

Per zerin nr.2 ne tabelen se mesiperme -Tubat e ujesllesit nga zeri1-21 te tabelës se artikujve, operatori ekonomik duhe te vertetoj me ane te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE se keto tuba jane te prodhuar sipas Normes –EN 12201-2 per tubat ne perdorim te ujesjellsave civil. Operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi.

Per Zeri nr.3 te tabelës se mesiperme – Kapak Gize per permasat 70x40,60x40,40x40 operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi.

Ne rastet qe Prodhuesi eshte subjekt qe ushtron aktivitetetin ne Republiken e Shqiperise duhet te vertetoj se disponon licence te posacme per te qene prodhues.

Per Zerin nr.4, Fashete PE elektrofuzive PN 16 Vetshpuese (zeri 273 deri ne 305), operatori ekonomik duhet te vertetoj me dokumentacion ne SPE se disponon AUTORIZIM PRODHUESI ose DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR te dedikuar per kete procedure prokurimi.

Ne rastet qe Prodhuesi eshte subjekt qe ushtron aktivitetetin ne Republiken e Shqiperise duhet te vertetoj se disponon licence te posacme per te qene prodhues.

2.4.1 P

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave, duke marrë në konsideratë vlerën e tyre, si dhe me qëllim verifikimin e specifikimeve teknike që ka secili artikull objekt prokurimi, duke krijuar kështu bindjen për ofrimin e artikujve që përmbushin kërkesat e DST. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit me artikujt e ofruara nga operatori ekonomik pjesmarres. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.5 Dëshmi per fuqine mesatare puntore te operatorit ekonomik :

Nje punesim mestar prej te pakten **3 (tre) persona** te cilet te jene shofere, per periudhen **dhjetor 2024-shkurt 2025** e dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi **(eSig25)(jo domosdoshmerisht me kodin shofer).**

Per shoferet duhet të paraqitet

- Leje drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Kontrata e punes

Kriteri Nr. 2.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedëklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me sipër do te paraqiten nga OE te sukseshem ne MK, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjës, përkatësisht shofer dhe punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion,

është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi sasisë së mallrave që do të transportohen. Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 3 (tre) person me profesionin shofer/punëtor i thjeshtë, Në lidhje me kërkesën që OE duhet të disponojë 2(dy) persona me profesionin shofer që disponon lejen përkatëse të drejtimit të mjetit dhe 1(një) punëtor të thjeshtë, duhet të jenë të regjistruar në listpagesat e shoqërisë dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave objekt prokurimi brenda afateve të ekzekutimit të kontratës. Për këto arsye, njësia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e nevojshme, proporcionale dhe është e mjaftueshme për t'i shërbyer synimit.

2.6 Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton	1	Pronësi ose me qira

Argumentim

- Mjeti i transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton nevojitet për transportin e materialeve të ndërtimit (hidraulike dhe elektrike)në sasi pak me të madhe ose për materiale të paketuara ose të sistemuara

-Per mjetet e transportit duhet te paraqiten:ne rast se jane ne pronesi dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto te mjetit ku te jete e dukshme targa e mjetit.

Kur mjetet jane me qera duhet te paraqitet :kontrata e qerave e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesisë, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit foto te mjetit ku te jete e dukshme targa e mjetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi dhe vendndodhjen gjeografike të autoritetit kontraktor përfitues.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.202 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Disponimi i mjeteve/pajiseje të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazes se nenshkrimit te kontrates duhet t'i dergoje kerkese ne rruge elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në

kopje të njëhësuar me origjinalin. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

➤ **Për mjetet e mësipërme OE duhet të paraqesë Çertifikatë për transportin e mallrave.**

Argumentim: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin Neni 45 të LIGJIT Nr.8308, datë 18.3.1998 PËR TRANSPORTET RRUGORE, të përditësuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë **Çertifikatën për transportin e mallrave**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.